



**Agjencia Kombëtare e Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve
Sektori i Profesioneve dhe Kualifikimeve Profesionale**

STANDARDI I KUALIFIKIMIT PROFESIONAL

TEKSTIL-KONFEKSIONE

Niveli IV në KSHK¹, referuar niveli IV të KEK²

D-IV-19

Tiranë, Tetor 2019

¹ Korniza Shqiptare e Kualifikimeve

² Korniza evropiane e Kualifikimeve

Emërtimi i kualifikimit	TEKSTIL-KONFEKSIONE			Kodi
Kohëzgjatja	900-1100 orë	Niveli	IV në KSHK, , referuar niveli III të KEK	D-IV-19
Qëllimi:	Qëllimi kryesor i kualifikimit profesional “Tekstil-konfeksione” niveli IV në KSHK, referuar niveli IV të KEK, është të përgatisë specialistë të nivelit “Teknik/menaxher” i mesëm në fushën e Tekstil - konfeksioneve dhe përgatitja e tyre për t’u punësuar në veprimtaritë e menaxhimit të një reparti, sektori, linje prodhimi ose njësie të ngjashme të kësaj fushe apo për krijimin e menaxhimit të një biznesi privat, person fizik ose juridik.			
Kriteret e përgjithshme të pranimit:	<p>Në institucionet e arsimit profesional që ofrojnë kualifikim profesional në “Tekstil-konfeksione” niveli IV në KSHK, referuar niveli IV të KEK, kanë të drejtë të regjistrohen të gjithë individët që:</p> <ul style="list-style-type: none"> kanë mbaruar arsimin profesional në një nga kualifikimet profesionale të nivelit III (KSHK), referuar niveli III të KEK në drejtimit mësimor “Tekstil-konfeksione”. Janë në kushte shëndetësore që të përballojnë kërkesat e këtij niveli të arsimit profesional. <u>kanë aftësi ndryshe</u>, për të cilët institucioni arsimor krijon kushte dhe përshtat programin në përputhje me paaftësitë që shfaqin. 			
Mundësitë e kualifikimit të mëtijshëm dhe të punësimit:	<p>Përfundimi me sukses i kualifikimit profesional në “Tekstil-konfeksione” niveli IV në KSHK, referuar niveli IV të KEK, e pajis individin me Certifikatën Profesionale dhe Supplementin përkatës të këtij niveli, si teknik/menaxher i mesëm në këtë fushë, të cilat njihen në territorin e Republikës së Shqipërisë.</p> <p>Ky arsimim i jep mundësi individit t’i drejtohet tregut të punës për t’u punësuar në ndërmarrje të ndryshme që ushtrojnë aktivitetet në drejtimin e tekstil – konfeksioneve.</p> <p>Gjithashtu, individi mund të vetëpunësohet në kuadrin e një biznesi mikro, të vogël apo të mesëm në fushën e tekstileve dhe konfeksioneve ose artizanatit.</p> <p>Me përfundimin e këtij niveli, individi ka mundësi për të fituar të drejtën e Diplomës së “Maturës Shtetërore Profesionale”, me mundësi për vazhdimin e studimeve universitare.</p>			
Data e validimit				
Data e miratimit				
Variantet e mëparshme	D-III-15			

STRUKTURA E KUALIFIKIMIT

Rezultatet e të nxënit në:

NJOHURI

Individi duhet të dijë:

Sipermarrje dhe menaxhim

- Të shpjegojë rolin social dhe ekonomik të sipërmarrjes në krijimin e një shoqërie të qëndrueshme;
- Të shpjegojë sipërmarrjen me të gjithë elementët kryesorë të saj;
- Të shpjegojë lidhjen midis sipërmarrjes dhe veprimtarisë njerëzore;
- Të përshkruajë fazat e zhvillimit të biznesit në kontekstin e globalizimit;
- Të analizojë format e ndryshme të sipërmarrjes në lidhje me synimet kryesore të karrierës personale, mundësitë dhe përfitimet në komunitet;
- Të shpjegojë konceptet kryesore financiare (dokumentet financiare, institucionet financiare..);
- Të listojë komponentët e hartimit të një buxheti;
- Të përshkruajë fazat e menaxhimit të një projekti (duke identifikuar burimet e nevojshme për një projekt të veçantë);
- Të ilustrojë metoda të zgjidhjes së problemeve në kontekste të ndryshme;
- Të evidentojë mundësitë që ofron tregu i punës dhe kualifikimet e mëtejshme;
- Të analizojë interesat, zotësitë dhe aftësitë personale përmes mënyrave të ndryshme përfshirë vetëvlerësimin;
- Të përshkruajë lidhjen dhe ndryshimin midis sipërmarrjes dhe menaxhimit;
- Të shpjegojë funksionet themelore në menaxhimin e një biznesi;
- Të shpjegojë kuptimin dhe nevojën për menaxhimin e burimeve njerëzore (personelit), duke u përqendruar në mënyrën e drejtimit, integritit, motivimit dhe mbikëqyrjes së tyre;
- Të listojë mjetet e nevojshme për sigurimin, ruajtjen, vlerësimin dhe shpërndarjen e informacionit, për të realizuar vendim-marrje në biznes;
- Të shpjegojë kuptimin, rëndësinë, mjetet dhe strategjitë e marketingut në biznes;
- Të listojë kuadrin ligjor dhe detyrimet administrative në fushën e biznesit përkatës, si pjesë e rëndësishme e vendimmarrjes së tij;
- Të shpjegojë kuptimin e bankave, institucioneve financiare dhe shërbimet e tyre;
- Të përshkruajë mënyrën e llogaritjeve të thjeshta ekonomike që lidhen me prodhimin dhe tregtimin e produkteve të produkteve dhe shërbimeve në fushën e tekstil-konfeksionit;
- Të përshkruajë nocionin e të ardhurave dhe shpenzimeve për produktet dhe shërbimet

në fushën e tekstil-konfeksionit;

- Të interpretojë dokumentacionin financiar dhe teknik për produkte dhe shërbime në fushën e tekstil-konfeksionit;
- Të shpjegojë rëndësinë, nevojën dhe aspektet kryesore të përdorimit të Teknologjisë së Informimit dhe Komunikimit (TIK) dhe rrjeteve sociale për krijimin e kontakteve në biznes;

Kostot dhe Çmimet

- Të përshkruajë elementët e përcaktimit të kostos së prodhimit/shërbimit të një produkti të caktuar, kostot direkte dhe indirekte, (që përfshinë koston e materialeve kryesore, të materialeve ndihmëse, etj., të shpenzimeve direkte dhe indirekte, deri në magazinimin, transportin e produktit të gatshëm,... etj.);
- Të përshkruajë konceptin e normimit të punës në përgjithësi, kohët kryesore dhe ndihmëse të punës në makineri ose pajisje;
- Të shpjegojë mënyrën e llogaritjes së kohës për çdo proces pune;
- Të përshkruajë elementët e përcaktimit të çmimit të produktit/shërbimit (koston e produktit ku përfshihen: afati i realizimit, sasia e kërkuar, cilësitë ose karakteristikat e veçanta të produktit, garancinë dhe kushtet për mirëmbajtjen; fitimin e menduar duke pasur parasysh kërkesën e tregut, çmimin/ofertën e tregut për atë produkt ose produkte të ngjashme, grupin e synuar, etj.);
- Të interpretojë çmimet e materialeve bazë dhe atyre ndihmëse që përdoren në njësinë e prodhimeve/shërbimeve të tekstil-konfeksioneve, sipas veçorisë së tyre;
- Të përshkruajë mënyrat e furnizimit, afatin dhe ciklin e përdorimit, volumin dhe mënyrën e magazinimit të tyre, ... etj.;

Organizimi i punës

- Të përshkruajë rëndësinë e komunikimit dhe etikës profesionale në punë;
- Të përshkruajë rëndësinë e punës në ekip/grup dhe parimet kryesore;
- Të shpjegojë mënyrën e organizimit të punës për drejtimin/menaxhimin e njërive të prodhimeve/shërbimeve si, ndërmarrje, reparte, linja prodhimi, punishte etj.;
- Të përshkruajë mënyrën e hartimit të urdhrave të punës, të skedave teknologjike të thjeshta të prodhimit/shërbimit, të kontrollit teknik operacional dhe atij përfundimtar etj.;
- Të përshkruajë organizimin e procesit të prodhimit/shërbimit, sipas posteve të punës, deri në paketimin dhe magazinimin e prodhimit të gatshëm;
- Të shpjegojë përcaktimin e rezervës së nevojshme materiale (lëndë të para, ndihmëse etj.), për të mos penguar procesin e prodhimit/shërbimit;
- Të shpjegojë procedurën e transportit në përgjithësi, dokumentet kryesore të furnizimit apo shpërndarjes së prodhimeve/shërbimeve etj.;

Legjislacioni i punës dhe mbrojtja e mjedisit

- Të përshkruajë legjislacionin shqiptar të punës dhe rëndësinë e zbatimit të tij;
- Të përshkruajë legjislacionin shqiptar të sigurisë dhe të mbrojtjes së shëndetit në punë, që përfshin aspektet teknike, shkallët e përgjegjësisë, dokumentacionin e detyrueshëm, afatet e instruktimit të punonjësve etj.;
- Të përshkruajë legjislacionin shqiptar të mbrojtjes së mjedisit;
- Të përshkruajë rreziqet kryesore të ndotjes së mjedisit nga shkarkimet në mjedise të hapura, të lëndëve dhe mbetjeve jo miqësore me mjedisin, si p.sh. kimikate të ndryshme, vajrat të ndryshme, avujt e makinave etj.;
- Të përshkruajë veprimet e nevojshme që duhen kryer për të dhënë ndihmën e shpejtë për të dëmtuarin në punë;

Infrastruktura e ndërmarrjeve të tekstil – konfeksioneve

- Të interpretojë plan-vendosjet e reparteve dhe njësive të prodhimeve/shërbimeve të ndërmarrjeve të tekstil – konfeksioneve sipas profilit të tyre etj.;
- Të interpretojë plan-vendosjet e makinerive brenda një reparti prodhimi;
- Të shpjegojë funksionet e makinerive dhe pajisjeve kryesore në linjën apo njësinë e prodhimit, duke pasur parasysh parimin e veprimit, prodhimtarinë ose kapacitetin, fuqinë, shpejtësinë, përmasat, sistemin e komandimit etj.;
- Të analizojë proceset e punës të makinerive dhe pajisjeve kryesore në linjën apo njësinë e prodhimit, duke pasur parasysh parimin e veprimit, prodhimtarinë ose kapacitetin, fuqinë, shpejtësinë, përmasat, sistemin e komandimit e të sigurisë në punë të tyre etj.;
- Të përshkruajë karakteristikat teknike të makinerive dhe pajisjeve kryesore në linjën apo njësinë e prodhimit.

Mirëmbajtja

- Të përshkruajë mënyrat e mirëmbajtjes ditore, të makinerive dhe pajisjeve në njësitë prodhuese, si para fillimit të procesit të punës edhe në mbarimin e saj;
- Të përshkruajë defektet e thjeshta dhe parregullsitë në makineritë e pajisjet në njësinë prodhuese;
- Të përshkruajë hartimin e planit të remontit periodik dhe vjetor për makineritë, pajisjet, impiantet dhe parashikimin e kostos për kryerjen e remonteve;

Standardet teknike, dokumentacioni

- Të interpretojë skedën teknike që shoqëron produktin në repartet e prodhimit/shërbimit të ndërmarrjeve të tekstil – konfeksioneve ... etj.;
- Të përshkruajë standardet e prodhimeve të tekstil - konfeksioneve dhe rregulloret teknike kombëtare dhe ndërkombëtare;
- Të përshkruajë standardet për paketimin dhe tregtimin e prodhimeve të tekstil -

konfeksioneve;

- Të përshkruajë mënyrën e formulimit të propozimeve dhe argumentimin e tyre lidhur me prodhimin apo shërbimin në njësinë përkatëse apo në marrëdhënjet me klientin;
- Të përshkruajë mënyrën e trajtimit dhe të ruajtjes së informacionit;

teknologjisë së informacionit dhe komunikimit (TIK)

- Të përshkruajë rëndësinë e përdorimit të teknologjisë së informacionit dhe komunikimit (TIK);
- Të përshkruajë përdorimet dhe rëndësinë e Programeve kompjuterik “CAD”, për projektimin në fushën e tekstil – konfeksioneve;
- Të shpjegojë mënyrën e realizimit të veshjeve të ndryshme me programin CAD (fundi, fund-pantallona, pantallona, bluza, këmisha, fustani, xhaketa, pallto etj.);
- Të shpjegojë mënyrën e zërthimit të veshjes në detaje;
- Të përshkruajë mënyrat e përcaktimit të tolerancave (marzheve) të qepjes;
- Të përshkruajë rëndësinë e vendosjes së cikatjeve dhe mënyrën e përcaktimit të tyre;
- Të përshkruajë mënyrën e ndryshimit të detajeve mbi bazën e modelit (forma xhepush, jaka, mansheta, supanja etj.);
- Të përshkruajë rëndësinë e ekonomizimit të lëndës bazë nëpërmjet programit CAD;
- Të përshkruajë zhvillimin e numrave nëpërmjet programit CAD;
- Të përshkruajë rëndësinë e kalimit të modelit nga programi CAD në prerjet e ploterit në masë reale.

Mbikëqyrja

- Të përshkruajë rëndësinë e mbikëqyrjes së punës në një repart;
- Të përshkruajë rëndësinë e ndarjes së detyrave dhe instruktimit para fillimit të punës;
- Të përshkruajë rregullat e sigurimit teknik dhe të sigurisë në punë gjatë përdorimit të mjeteve të punës;
- Të përshkruajë rregullat e sigurimit teknik dhe të sigurisë në punë gjatë zhvendosjeve në vendin e punës;
- Të përshkruajë rregullat e sigurimit teknik dhe të sigurisë në punë gjatë përdorimit të makinave të ndryshme të tezgjahut;
- Të përshkruajë rregullat e sigurimit teknik dhe të sigurisë në punë gjatë përdorimit të pajisjeve dhe mjeteve të punës;
- Të përshkruajë rëndësinë e instruktimit për rregullat e sigurimit teknik para fillimit të punës dhe mbikëqyrjes së zbatimit të tyre;
- Të përshkruajë zbatimin e rregullave të higjienës gjatë punës;
- Të përshkruajë zbatimin e rregullave të ruajtjes së mjedisit.

SHPREHI PROFESIONALE

Individi duhet të jetë i aftë:

Sipërmarrja dhe menaxhimi

- Të demonstrojë aftësi për të zhvilluar një projekt ide sipërmarrëse (për të zhvilluar dhe zbatuar një buxhet të caktuar);
- Të përdorë metoda dhe teknika të ndryshme të zbatimit të një projekti;
- Të analizojë të dhëna për të marrë vendimet e duhura në kontekste të ndryshme;
- Të identifikojë dhe të zgjidhë problemet në mënyrë krijuese;
- Të negociojë ide me të tjerët në mënyrë efektive;
- Të demonstrojë aftësi për të planifikuar, për të kontrolluar me qëllim vetë-përmirësimi;
- Të vlerësojë aftësitë profesionale dhe sociale për të shfrytëzuar avantazhin konkurrues;
- Të mbikëqyrë të tjerë në situata të ndryshme;
- Të aplikojë parimet e ekonomisë së lirë të tregut në situata të ndryshme;
- Të motivojë dhe inkurajojë të tjerët në arritjen e synimeve të tyre;
- Të planifikojë dhe menaxhojë projekti thjeshta në situata të ndryshme;
- Të sigurojë burime e duhura dhe të marrë përgjegjësinë për t'u kujdesuar për to.
- Të menaxhojë stafin profesional, duke promovuar talentet dhe zhvillimin e mundësive të karrierës.
- Të zbatojë funksionet themelore në menaxhimin e një biznesi;
- Të hartojë një plan efektiv biznesi në fushën e prodhimit/shërbimit të tekstil - konfeksioneve, për krijimin e një biznesi të ri, për njësi të vogla prodhimi/shërbimi, për linja apo reparte prodhimi, duke u bazuar në procedura standarde;
- Të përdorë mjete dhe strategji të marketingut në biznes.
- Të bashkëpunojë me bankat apo institucione të tjera financiare për nevoja të biznesit;
- Të kryejë llogaritje të thjeshta ekonomike që lidhen me prodhimin dhe tregtimin e produkteve të produkteve dhe shërbimeve në fushën e tekstil-konfeksionit;
- Të kryejë llogaritje të të ardhurave dhe shpenzimeve për produktet dhe shërbimet në fushën e tekstil-konfeksionit;
- Të plotësojë dhe ruajë dokumentacionin financiar dhe teknik për produkte dhe shërbime në fushën e tekstil-konfeksionit;
- Të përdorë Teknologjinë e Informimit dhe Komunikimit (TIK) dhe rrjeteve sociale për krijimin e kontakteve në biznes;

Normimi i punës, kostot dhe çmimet

- Të bëjë normimin e punës, duke pasur parasysh kohët kryesore të përgatitjes së produktit si dhe kohët e nevojshme në tërësinë të operacioneve ndihmëse (të përcaktuara në procesin teknologjik), deri në ambalazhimin e magazinimin e tyre;
- Të kryejë llogaritje të thjeshta të kostos së prodhimit të një produkti/shërbimi të

- caktuar, duke marrë parasysh të gjithë elementet e saj, (kostot direkte dhe indirekte) ;
- Të kryejë llogaritje të thjeshta të çmimit të produktit/shërbimit, duke marrë parasysh koston e prodhimit dhe gjithë elementet e tjerë që influencojnë në çmimin e produktit si; fitimin e menduar, sasinë e kërkuar, kërkesën e tregut, çmimin/ofertën e tregut për produkte të ngjashme, cilësitë ose karakteristikat e veçanta të produktit, garancinë, kushtet për mirëmbajtjen dhe sigurimin etj.);
- Të llogaritë kohën për çdo etapë dhe proces pune.

Organizimi i punës

- Të organizojë punën duke zbatuar parimet e punës në ekip/grup;
- Të organizojë proceset e prodhimit/shërbimit, sipas pozicioneve të punës dhe procesit teknologjik të përcaktuar, deri në magazinimin e tyre;
- Të përcaktojë ngarkesën e pozicioneve të punës (linjës së prodhimit/shërbimit), ndarjen e detyrave sipas (grup) personave përgjegjës, duke ndjekur hierarkinë, detyrat dhe përgjegjësitë e tyre, marrëdhëniet në organizimin e pozicioneve të punës, mënyrën raportimit, afatet, etj.;
- Të zbatojë rregullat e komunikimit dhe parimet e etikës profesionale me punonjësit, vartësit dhe eprorët;
- Të kryejë menaxhimin e burimeve njerëzore duke kuptuar sjelljet e individit/grupit dhe duke aplikuar me efikasitet teknikat e motivimit, si uljen apo ngritjen në përgjegjësi, motivimin material e moral, etj.;
- Të përdorë makineri/pajisje kryesore në njësinë prodhuese që menaxhon;
- Të përdorë të gjitha mjetet e pajisjet matëse të njësisë së prodhimit/shërbimit;

Legjislacioni i punës dhe mbrojtja e mjedisit

- Të zbatojë legjislacionin shqiptar të punës, duke përfshirë të drejtat dhe detyrimet e punëdhënësit dhe punëmarrësit.
- Të asistojë në hartimin e një kontrate pune individuale, duke përfshirë, kushtet specifike për llojin e punës që do të kryejë punonjësi.
- Të zbatojë legjislacionin shqiptar të mbrojtjes së mjedisit, duke përfshirë, përveç aspekteve teknike, plotësimin e dokumentacionit të detyrueshëm për raportimet periodike etj.;
- Të kontrollojë zbatimin e standardeve, urdhrave e sugjerimeve të organeve shtetërore për menaxhimin e mbetjeve në njësinë e vet të punës;
- Të mbikëqyrë përdorimin e pajisjeve të nevojshme për neutralizimin e efekteve të lëndëve dhe mbetjeve jo miqësore me mjedisin etj.;
- Të afishojë, për çdo post pune, rregullat e sigurimit teknik në punë;
- Të përdorë pajisjet mbrojtës individuale dhe kolektive, sipas specifikës së punës që do kryejë;
- Të respektojë rregullat e mirëmbajtjes së pajisjeve dhe makinerive të punës;

- Të identifikojë produktet e rrezikshme të përdorura në kuadër të profesionit, t'i përdorë me kujdes në kuadër të respektim rregulloreve në fuqi;
- Të ndajë dhe të largojë mbetjet dhe produktet e dëmshme në kuadër të respektimit të rregullave të mbrojtjes së ambientit;
- Të respektojë masat e sigurisë dhe të higjienës kolektive dhe individuale,
- Të kryejë veprimet e nevojshme që duhen për të dhënë ndihmën e shpejtë për të dëmtuarin në punë;

Mirëmbajta

- Të evidentojë mirëmbajtjen ditore të makinerive dhe pajisjeve në njësitë prodhuese, si para fillimit të procesit të punës edhe në mbarimin e saj;
- Të evidentojë dhe raportojë defektet e thjeshta dhe parregullsitë në makineritë e pajisjet në njësinë prodhuese dhe të konsultohet me teknikët;
- Të hartojë planet e remontit periodik dhe vjetor për makineritë, pajisjet, impiantet duke parashikuar koston për kryerjen e remonteve;

Standardet teknike dhe dokumentacioni

- Të zbërthejë skedën teknike që shoqëron produktin në repartet e prodhimit/shërbimit të ndërmarrjeve të tekstil – konfeksioneve etj.;
- Të zbatojë standardet e prodhimeve të tekstil - konfeksioneve dhe rregulloret teknike kombëtare dhe ndërkombëtare;
- Të zbatojë standardet për paketimin dhe tregtimin e prodhimeve të tekstil – konfeksioneve dhe dokumentet shoqëruese;
- Të propozojë ide për përmirësimin e cilësisë së prodhimit/shërbimeve dhe t'i argumentojë ato;
- Të ruajë informacionin konfidencial në lidhje me teknikat dhe teknologjinë e prodhimit në ndërmarrjet e tekstil – konfeksioneve;

TIK

- Të përdorë teknologjinë e informacionit dhe komunikimit, për shkëmbimin e informacionit, për shkëmbim eksperience, për kërkime personale në të mirë të punës etj.;
- Të përdorë programe kompjuterike “CAD”, për projektimin në fushën e tekstil – konfeksioneve.
- Të realizojë kallëpin e veshjeve të ndryshme me programin CAD (fundi, fund-pantallona, pantallona, bluza, këmisha, fustani, xhaketa, pallto etj.);
- Të zbërthejë kallëpin e veshjes në detaje;
- Të përcaktojë tolerancat (marzhet) e qepjes në kallëpet e realizuara me programin CAD;
- Të përcaktojë dhe vendosë cikatjet në kallëpin e veshjeve;
- Të ndryshojë detajet mbi bazën e modelit (forma xhepush, jaka, mansheta, supanja

etj.);

- Të vendosë në mënyrë ekonomike kallëpet e veshjes mbi lëndën bazë nëpërmjet programit CAD;
- Të realizojë zhvillimin e numrave në kallëpet e prerjes nëpërmjet programit CAD;
- Të kalojë modelin nga programi CAD në prerjet e ploterit në masë reale.

Mbikëqyrja e të tjerëve për zbatimin e rregullave të sigurimit teknik

- Të mbikëqyrë punën në një repart sipas detyrave të paracaktuara;
- Të kryejë instruktive e nevojshme para fillimit të punës;
- Të mbikëqyrë zbatimin e rregullave të sigurimit teknik dhe të sigurisë në punë gjatë përdorimit të mjeteve të punës;
- Të mbikëqyrë zbatimin e rregullave të sigurimit teknik dhe të sigurisë në punë gjatë zhvendosjeve në vendin e punës;
- Të mbikëqyrë zbatimin e rregullave të sigurimit teknik dhe të sigurisë në punë gjatë përdorimit të makinave të ndryshme të tezgjahut;
- Të mbikëqyrë zbatimin e rregullave të sigurimit teknik dhe të sigurisë në punë gjatë përdorimit të pajisjeve dhe mjeteve të punës;
- Të mbikëqyrë zbatimin e rregullave të higjienës gjatë punës;
- Të mbikëqyrë zbatimin e rregullave të ruajtjes së mjedisit.

KOMPETENCA TE PERGJITHSHME

Individi duhet të jetë i aftë:

- Të komunikojë në mënyrë korrekte me shkrim e me gojë për të shprehur mendimet e ndjenjat e tij dhe për të argumentuar opinionet për çështje të ndryshme kulturore, sociale, ligjore, organizative e tekniko-profesionale.
- Të përdorë burime dhe teknika të ndryshme të mbledhjes dhe të shfrytëzimit të informacioneve të nevojshme për zhvillimin e tij personal dhe profesional dhe ti shpërndajë ato, në dobi të kolegeve e punonjësve në njësisë e tij prodhuese.
- Të nxisë potencialin e tij të brendshëm në kërkim të vazhdueshëm për zgjidhje të reja më efektive dhe më eficiente.
- Të ndër marrë apo hedhë vazhdimisht ide të reja, duke hartuar projekte të reja, struktura të reja organizative, të cilat sjellin përmirësimin e strukturave ekzistuese.
- Të angazhohet fizikisht, mendërisht dhe emocionalisht në kryerjen e detyrave të ndryshme në kontekstin profesional, personal dhe shoqëror.
- Të respektojë rregullat dhe parimet e një bashkëjetese demokratike në kontekstin e integriteteve lokale, rajonale.
- Të manifestojë guxim dhe aftësi sipërmarrëse për të ardhmen e tij.
- Të tregojë vetëkontroll gjatë ushtrimit të veprimtarive të tij, të jete i matur dhe i

sjellshëm me eproret, vartësit, partneret, etj.

- Të organizojë drejt procesin e të nxënit të tij dhe të shfaqë gatishmërinë dhe vullnetin për të nxënë gjatë gjithë jetës.
- Të respektojë parimet e punës në grup dhe të bashkëpunojë aktivisht në arritjen e objektivave të pranuar.
- Të vlerësojë dhe vetëvlerësojë aftësitë e tij, nisur nga kritere të drejta, si bazë për të përmirësuar dhe çuar më tej arritjet e tij.
- Të jetë i hapur dhe të veprojë si një ndërlidhës midis njësisë së tij prodhuese dhe njësisë të tjera brenda ndërmarrjes apo ndërmjet ndërmarrjes dhe të tretëve jashtë saj, si furnitorët, klientët, partneret, etj., duke ndihmuar në realizimin e qëllimeve të njësisë prodhuese.
- Të demonstrojë aftësi për të përmbushur detyrat brenda afateve sipas një plani të caktuar;
- Të marrë nisma për të bashkëpunuar më individë apo grupe;
- Të demonstrojë sjellje të përgjegjshme dhe etike në veprimtari shkollore dhe komunitet;
- Të demonstrojë aftësi për të punuar në mënyrë të pavarur dhe për qenë pjesëmarrës proaktiv në grup;
- Të demonstrojë përgjegjshmëri ndaj mjedisit dhe të mirave publike;
- Të pranojë dhe të promovojë risitë dhe ndryshimet;
- Të demonstrojë marrjen e nismave për të zhvilluar dhe zbatuar një ide;
- Të demonstrojë zotësi për të nxënë nga dështimet dhe për të këmbëngulur drejt arritjes së synimeve të tij/saj;
- Të aplikojë mënyra konstruktive të përgjigjeve ndaj kritikave.